



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

E-bulletin

Dhjetor, 2019

Institucionet e Arsimit Parauniversitar në grevë dyorëshe

Veprim i arsyeshëm për të shprehur pakënaqësinë dhe zhgënjin



Këshilli Drejtues i SBASHK-ut në një takim bashkë me kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të Universiteteve kishin debatuar për gjendjen e krijuar në tërë sektorin e arsimit pas dërgimit të Ligjit të pagave në Kushtetuese nga ana e Avokatit të popullit.. Në atë takim kryetarët e nivelit sindikal komunal kishin raportuar se është krijuar një atmosferë pakënaqësie e zhgënji mes të punësuarve në të gjitha institucionet e Arsimit ... (faqe 4)

Angazhim i përbashkët i tri sindikatave në përballje me sfidat

Zëri i përbashkët jehon më shumë




Fjalët që kishin nisur të merrnin dheun se ... (faqe 7)

Qindra trajnime të mbajtura këtë vit kudo në Kosovë

Pjesëmarrësit nuk ishin vëzhgues të heshtur, po mbështetës të rrjedhës së trajnimeve



Trajinimet janë vetëm njëri nga angazhimet... (faqe 4)



Mediet, ueb faqja, gazeta
mujore dhe ajo vjetore Krahas
shumë. (faqe 7)

Në vend të intervistës në
këtë fundvit

**Mesazhe urimi nga stafi i
SBASHK-ut**



Rrahman Jasharaj, kryetar i
SBASHK-ut,

Të nderuar anëtarë të
SBASHK-ut, ... (faqe 3)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Po shkon edhe ky vit



Me urimin që viti 2020 të jetë i stolisur me lajme të mira për të gjithë ne po nisi këtë shkrim për gazetën "Arsimimi sot". Gazetën e kemi botuar në fund të çdo muaji edhe gjatë gjithë vitit 2019. Lexues të nderuar jemi munduar t'ju sjellim në të njëjtin vend ngjarjet kyçë me përpjekjet që të mbesin të arkivuara angazhimet e SBASHK-ut. Dhe ju t'i lexoni kur të keni kohë e dëshirë. Nga shkrimet ditore, nga publikimet në medie të shkruara e elektronike shihet se ishte ky një vit i vështirë e me plot sfida, por edhe një vit i stolisur me punë, përkushtim, unitet e arritje të shumta të SBASHK-ut.

U aprovua Ligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta dhe, sa do që është shtyrë vënia në jetë e tij, ai

u bë realitet. Ndryshuam me shumë mund e sakrifica edhe koeficientët në Ligjin e pagave dhe ai do të duhej të hynte në funksion pikërisht në këtë muaj, por ja që ligji u pezullua deri në mars. Kjo ngjalli reagime te punëtorët e arsimit, te ata të shëndetësisë e po ashtu edhe te policia e Kosovës. Me arsyen këta të gjithë ishin të zhgënjer se po pritnin me muaj të shohin efektet e këtij ligji. Ky zhgënjim u shpreh me grevë në tërë sistemin e arsimit dhe atë të shëndetësisë.

Gjatë gjithë vitit 2019 kishim lajme e momente të gëzuara, lajme e momente plot sfida e shqetësime, por në kujtesën tonë do të mbetet lajmi plot dhembje për vdekjen e hershme të koleges sonë Mehribane Mustafa. Ajo ishte e respektuar nga të gjithë. Ishte anëtare shembulllore e Këshillit Drejtues. Kujtimi për të do të lartësohet gjithmonë.

Ky vit po shkon e ne të gjithë urojmë që vitet tjera që vijnë mos të na sjellin lajme të hidhura, po lajme të mira për gjithë të punësuarit në sektorin arsimit.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të viziton ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos heziton të na jepni sygjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektonike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rrëth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rrëth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit International (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Mesazhe urimi nga stafi i SBASHK-ut



Rrahman Jasharaj, kryetar i SBASHK-ut,

Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut, lexues të respektuar të gazetës sonë kaluan bashkë një vit plot sfida, por me unitet e këmbëngulësi arritëm të shënojmë bashkërisht edhe suksese. Kemi edhe shumë punë për të bërë dhe unik e të vendosur do ia dalim. Paçi fat e shumë suksese në vitin 2020.

Vjollca Shala, nënkyetare ,

Urimet më të mira për vitin 2020 për të gjithë anëtarët e SBASHK-ut. Viti 2019 ishte nga më të vështirët dhe me plot sfida. Besoj se kemi arritur të jemi zëri juaj kudo në takime, në dialog dhe në përkushtimin për realizimin e kërkesave tuaja. Bashkërisht do të vazhdojmë rrugëtimin drejt arritjeve të reja. Gëzuar!

Ymer Ymeri, menaxher për financa dhe administratë,

Duke u ndjerë krenar me të gjithë ju anëtarë të SBASHK-ut ju përgëzoj për unitetin. Besimin që tregoni ndaj SBASHK-ut jemi munduar ta ruajmë dhe arsyetojmë duke u angazhuar çdo ditë në shërbim të realizimit të kërkesave tuaja. Kështu do të verojmë edhe në të ardhmen.

Lutfi Mani, këshilltar,

Anëtarë të nderuar të SBASHK-ut uroj që viti që po vjen të jetë me plot arritje e suksese për ju. Fat të mirë e suksese të shumta në jetë.

Blendor Shatri, zyrtar ligjor,

Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut dhe ju pensionistë të respektuar ju uroj çdo të mirë në jetë. Urime për festën. Me ju bashkë nëpër vite e dekada do të angazhohemi për të realizuar kërkesat legitime. Fat e suksese në jetë.

Afërdita Ahmeti, zyrtare administrative,

Lexuesve të gazetës sonë ju uroj çdo të mirë në jetë. Bashkërisht kemi kaluar një vit me plot sfida e angazhime. Jemi munduar të jemi në krye të detyrës. Besoj se ia kemi dalë. Suksese të përbashkëta edhe në vitet e dekadat që po vijnë.

Vlora Rexhepi Berisha , asistente në SBASHK,

Lexues të nderuar, kolege e kolegë sindikaliste me respekt të lartë ju përshtendes kudo jeni. Një vit plot sfida po ik. Uroj që për të gjithë ne viti që po vjen të sjellë gjëzime e lumturi. Gëzuar!

Nezafete Jakupi, libërmajtëse,

Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut jemi munduar ta arsyetojmë besimin tuaj. Me punë e përkushtim do të vazhdojmë edhe në të ardhmen. Bashkërisht drejt arritjeve dhe sukseseve të reja. Fat e çdo të mirë në jetë.

Albina Arifi, zyrtare për medie dhe trajnime,

Ju të nderuar anëtarë të SBASHK-ut kudo në komunat e Kosovës jemi munduar t'ju informojmë sa më saktë e sa më shpejt për ngjarjet dhe angazhimet e shumta. Gjatë vitit 2019 u organizuan shumë trajnime dhe jemi munduar që të jemi sa më të përgatitur çdo gjë të shkojë ashtu si duhet. Gëzuar!

Gjatë muajit

Institucionet e Arsimit Parauniversitar në grevë dyorëshe

Veprim i arsyeshëm për të shprehur pakënaqësinë dhe zhgënjinin

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut në një takim bashkë me kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të Universiteteve kishin debatuar për gjendjen e krijuar në tërë sektorin e arsimit pas dërgimit të Ligjit të pagave në Kushtetuese nga ana e Avokatit të popullit.



Në atë takim kryetarët e nivelit sindikal komunal kishin raportuar se është krijuar një atmosferë pakënaqësie e zhgënji mes të punësuarve në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar për shkak se Avokati i popullit e ka dërguar në Kushtetuese Ligjin e pagave e aq më tepër pasi Kushtetuesja e ka pezulluar këtë Ligj deri më 30 mars 2020. Këshilli Drejtues me qëllim që të respektohet marrëveshja, me sindikalistët e mjekësisë autorizuan

kryetarin dhe kryesinë e SBASHK-ut, që të fillohet me veprime sindikale në të njëjtën ditë kur kjo të ndodh edhe në sektorin e mjekësisë. Kështu edhe u bë. Të premtën e 13 dhjetorit i tërë sektori i arsimit ishte në grevë dyorëshe, kurse ai i shëndetësisë në grevë njëditore.



Këshilli Qendror grevist mblodhi shënimet përkëtë grevë nga Këshillat Grevist nëpër komuna dhe publikoi reportin nga i cili shihet se nga 1116 institucione arsimore parauniversitare, gjegjësisht nga 784 shkolla amë dhe 332 paralele të ndara në grevë ishin 1101, ndërsa pjesërisht apo plotësisht në grevë nuk kanë marrë pjesë vetëm 15 sosh, gjegjësisht 20 në ndërrimin e pasdites.

Pas këtij veprimi sindikal selia qendrore e SBASHK-ut ka zhvilluar komunikim të vazhdueshëm me kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe i ka udhëzuar ata që të bashkëbisedojnë me të gjithë të punësuarit në arsim për të marrë ide se si do të veprohet tutje.

Qindra trajnime të mbajtura këtë vit kudo në Kosovë

Pjesëmarrësit nuk ishin vëzhgues të heshtur, po mbështetës të rrjedhës së trajnimeve



Trajnimet janë vetëm njëri nga angazhimet e SBASHK-ut, por ai ka krijuar interesim të madh mes

mësimdhënësve dhe ajo që gjëzon është se ky aktivitet po mundëson që pjesëmarrësit të marrin njohuri të reja, por edhe të ofrojnë ide konkrete për angazhimet sindikale në vijim. Vikendet e muajit dhjetor po shënojnë përmbylljen e trajnimeve të planifikuara përvitin 2019.

Në fillimet e këtij aktiviteti u nis me një numër të vogël grupesh për trajnimet "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" me 32 orë trajnim, "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" me 28 orë, "Aplikimi i



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

programeve kompjuterike në mësimdhënie" me 103 orë , "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik me 32 orë " dhe "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm ", po ashtu me 32 orë trajnim. Por, nuk shkoi shumë kohë dhe kërkesat nga terreni u shtuan dukshëm. Në selinë e SBASHK-ut koordinatoret e trajnimeve Ymer Ymeri e Vjollca Shala çdo mëngjes në takimet e stafit analizonin kërkesat bashkë me zyrtaren për trajnime dhe kujdeseshin që asgjë mos të ik sepse trajnimet u bën të shumta dhe duhej kujdes i vazhdueshëm për rrjedhën e tyre të mbarë. Tani kur edhe ky vit po përfundon janë bërë edhe vlerësimet e këtij aktiviteti, që kishte për qëllim që anëtarëve të SBASHK-ut t'u mundësonte marrjen e njohurive të reja në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim dhe sigurimin e numrit sa më të madh të orëve të trajnimit që kerkohen për licencën e re të punës dhe për të qenë sa më të përgatitur për nisjen e procesit të gradimit.



"Gjatë vitit 2019 janë shënuar arritje të konsiderueshme në organizimin e trajnimeve për kolegët tanë kudo në Kosovë. Deri tani në të pesë trajnimet kanë marrë pjesë 1530 punëtorë të arsimit, prej të cilëve 1207 kanë marrë certifikatë, si dëshmi e kryerjes me sukses të trajnimit, certifikata këto të nënshkruara nga kryetari i SBASHK-ut, nga Drejtori i Departamentit të Arsimit Parauniversitar, Alush Istogu dhe nga trajnerët varësisht se për cilin trajnim është fjala. Edhe të 323 pjesëmarrësit në trajnime, që janë organizuar gjatë këtyre vikendeve të fundit, do të marrin certifikata ditëve në vijim ngase ato janë në proces të shtypjes dhe nënshkrimit nga personat e autorizuar ", tregon koordinatori për trajnime, Ymer Ymeri.



Ky aktivitet do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm duke u bazuar në kërkesat e anëtarësisë kudo nëpër komunat e Kosovës.

Përfaqësues të SBASHK-ut vizituan Universitetin "Hyzri Varoshi" në Ferizaj Festë e fjalës së shkruar



Rektori Agron Bajraktari dhe të punwsuarit e tjerë kishin krijuar një atmosferë vërtetë festive në ambientet e Universitetit të Shkencave të Aplikuara

"Hyzri Varoshi" në Ferizaj . Ata po pritnim mysafirë nga e tërë Kosova për t'u bërë bashkë në festën e fjalës së shkruar me rastin e promovimit të librit "Turizmi ndërkombëtar" i autorit prof. dr. Hysen Sogojeva.

Rektori Bajraktari ka pritur fillimisht në zyrën e tij kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj dhe menaxherin për financa e administratë, Ymer Ymeri dhe u ka treguar atyre për rritën e mbarë të këtij institucionit të lartë të arsimit. Pas kësaj ata bashkë me

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

shumë mysafirë të tjerë janë gjendur në sallën, në të cilën u mbajt promovimi i librit. Te autorri Sogojeva vërehej lehtë ndjenja e gëzimit që pas gjithë atij hulumtimi e përkushtimi libri po merrte rrugëtimin drejt lexuesit, por vërehej te ai edhe krenaria ngase të gjithë në këtë institucion të arsimit të lartë ishin bërë si një për të organizuar sa më mirë këtë festë të librit.



Duke nisur festën e promovimit të librit "Turizmi ndërkombëtar", rektori Bajraktari është shprehur krenar me stafin që ai drejton dhe ka kujtuar shumë nga arritjet, që këtë Universitet e kanë bërë të shënojë arritje të larta.



Në pjesën e parë të kësaj festë recensemët Prof. as. Dr. Sokol Krasniqi dhe dr. Sc. Armend Pushkule, kanë folur për librin duke vlerësuar lartë punën e prof. dr. Sogojevës si profesor i lëndëve që lidhën me turizmin, por edhe për punën e bërë shkencore e duke botuar edhe këtë libër, që do të jetë një ndihmesë e madhe për studentët, por edhe për gjithë njerëzit që janë të angazhuar e të ndërlidhur me turizmin. Ata i kanë dhënë obligim autorit Sogojeva që të vazhdojë me punën dhe përkushtimin dhe të nxjerr në dritë edhe botime të tjera nga sfera e turizmit. Autorin e kanë përgëzuar për librin edhe shumë nga mysafirët, por edhe studentët e këtij Universiteti.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka nisur përshëndetjen e tij me ca nuanca humorë duke theksuar se sa herë e shohin njerëzit atë në tubime presin që të flas e të shpall greva, por ai sot ka një obligim tjetër sepse përcjellë në këtë festë të librit përgëzimet dhe krenarinë për autorin nga të gjithë anëtarët e sindikatës së arsimit. "Njerëzit që shkruajnë e botojnë libra janë ushtarët më të mirë të dijes e dritës kundër errësirës. SBASHK-u krenohet me dr. Sogojevën sepse ai sindikatën tonë dhe figurën e mësimdhënësit e prezanton në mënyrën më të denjë kudo gjatë angazhimeve të tij, por edhe në trajnimet e organizuara nga SBASHK me punëtorët e arsimit kudo në Kosovë."



Respektin për SBASHK-un rektori Bajraktari dhe profesorët e nderuar këtu e kanë shprehur duke i shoqëruar ata për vizitë nëpër ambientet e mësimit e të punës praktike këtu. Të gjithë ata që vërtetë e duan arsimin dhe i gëzohen arritjeve të larta në këtë sektor duhet të vizitojnë kabinetet dhe ambientet, në të cilat arritjet teorike kthehen në punë praktike nga studentët. "Njeriu s'ka si të mos ndihet krenar që edhe në Kosovë kemi institucione të tillë arsimore dhe njerëz kaq të përkushtuar e të betuar se do të arrijnë dije sa më të larta dhe do ta lartësojnë emrin e këtij institucioni shembullor", është shprehur kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj teksa nuk ndalej duke bërë pyetje që lidheshin me aparaturat dhe mjetet tjera të punës praktike në këtë institucion arsimor.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Angazhim i përbashkët i tri sindikatave në përballje me sfidat

Zëri i përbashkët jehon më shumë

Fjalët që kishin nisur të merrnin dheun se Avokati i popullit do ta nis për në Kushtetuese Ligjin e pagave me kërkesën pér pezullimin e tij u bënë realitet. Me qëllimin më të mirë që Avokatit t'ia shprehnin shqetësimin e mijëra të punësuarve në arsim, shëndetësi e polici, kryetarët e këtyre tri federatave më të mëdha sindikale e vizituan atë. Kryetari Jasharaj foli pér situatën në arsim, kryetari Syla pér gjendjen në shëndetësi, kurse kryetarja Kamberi shpjegoi gjendjen në policinë e Kosovës pas fjalëve se Ligji pér pagat ka gjasë të shkojë në Kushtetuese. Avokati i popullit dëgjonte i qetë dhe sikur nuk i bënte përshtypje ajo që deklaronin bashkëbiseduesit e tij. As alarmi se punëtorët në këto sektorë do të ndjehen shumë të zhgënjyer dhe se do të kërkojnë veprime sindikale nuk u pa se po ndryshonin gjë. Dukej sikur Avokati e kishte ndarë mendjen dhe se do ta dërgonte Ligjin në Kushtetuese. Ai mezi priti hyrjen në fuqi të Ligjit dhe pa kaluar as katër ditë e dërgoi atë në instancën më të lartë të drejtësisë duke ia shtuar edhe kërkesën pér pezullim. Edhe pezullimi ndodhi. Në këto tre sektorë pati reagime dhe shprehje e hapur e zhgënjimit dhe kërkesa pér veprime konkrete sindikale. Duke vazhduar me angazhimet të tri sindikatat iu drejtuani zyrtarisht me shkresa pér takime të ndara Presidentit dhe të gjithë kërve të institucioneve dhe të subjekteve politike. Përgjigje u mor vetëm nga kryetari i VV-së, Albin Kurti, i cili në selinë e partisë që drejton e bashkë me

udhëheqës të lartë të këtij subjekti politik takoi përfaqësuesit e të tri sindikatave dhe bashkëbisedoi me ta. Ai e tha atë që edhe ishte pér t'u thënë se Kushtetuesja është kupola e drejtësisë dhe se është e pavarur të veprojë e po ashtu se ai në situatën kur ende nuk ka arritur të krijoi Qeverinë e re nuk mund të deklarohet në kërkesat e sindikatës pér gjetjen e ndonjë alternative pér kalimin e gjendjes së krijuar deri në vendimin përfundimtar të Kushtetueses.



Të tri sindikatat vazhduan me angazhimet dhe mbajtën në vazhdimësi takime e konsultime. Këshillat Drejtues të SBASHK-ut dhe të FSSHK-së mbajtën takime të jaftëzakonshme dhe duke respektuar marrëveshjen që veprimet t'i kenë të koordinuara, vendosen që të shkojnë në një grevë paralajmëruese pér të treguar publikisht zhgënjimin e mijëra të punësuarve në këta sektorë pér shkak të mos realizimit të asaj që u tha e u përsërit vazhdimisht e me muaj të tërë se pagat e dhjetorit do të merren në bazë të Ligjit të pagave. Ky veprim sindikal u mbajt në shumicën absolute të institacioneve të arsimit dhe në shëndetësi.

Edhe këtë vit rëndësi e veçantë informimit të saktë e në kohë

Mediet, ueb faqja, gazeta mujore dhe ajo vjetore



Duke respektuar e realizuar objektivat nga Plani

strategjik, një rëndësi e dorës së parë i është dhënë edhe informimit të saktë e me kohë të anëtarësisë, por edhe gjithë opinionit në Kosovë. Ky angazhim ka qenë i suksesshëm edhe në vitin 2019 fal angazhimit të zyrës pér informim dhe gjithë stafit në qendër. Informimi i saktë e me kohë është arritur duke ruajtur korrektësinë dhe bashkëpunimin e sinqertë me mediet e shkruara e elektronike të cilave u janë shpërndarë në kohën më të shpejtë të mundur informatat pér aktivitetet, sfidat, angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut. Korrektësinë ndaj medieve SBASHK-u e ka



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

dëshmuar edhe me faktin se ka ftuar ato të përcjellin, jo vetëm aktivitetet festive e trajnimet, por edhe takimet e rregullta e ato të jashtëzakonshme të Këshillit Drejtues dhe kryetarëve të nivelit sindikal komunal dhe universiteteve duke ua mundësuar që të qëndrojnë në këto takime sa ata e kanë parë të udhës pavarësisht temave që debatoheshin e vendimeve që priteshin të merreshin.

The screenshot shows the official website of the Union of Education, Science and Culture (SBASHK). It features a red header with the union's logo and name. Below the header, there are several news items in a grid format. One prominent article is titled "Aktivitet i vëçantë dë shumë i sukseshëm i SBASHK-ut" (Successful activity organized by SBASHK) dated 28.10.2019. Another article mentions "Vendidhet me trajinet e licencuarë të SBASHK-ut ne Kosovë" (Training centers licensed by SBASHK in Kosovo) dated 11.Nov.2019. The website also includes a navigation bar with links like "Fillimi", "Për ne", "SBASHK", "Organizimi", "Financat dho Anotarësia", "Lajmo", "Projektet", "Marrëveshjet", "Galeria", and "Kontakti".

Po ashtu në shërbim të informimit të saktë e me kohë është punuar me kujdes edhe në pasimin e lajmeve nga aktivitetet në ueb faqen e SBASHK-ut, e cila ka qenë mirë e furnizuar me lajmet e ngjarjet ditore për aktivitetet e shumta të SBASHK-ut.



Me qëllim që lajmet më të rëndësishme gjatë ditëve të një muaji të janë afér anëtarësisë dhe të tjerëve zyra për informim ka përgatitur për çdo muaj gazeten "Arsimimi sot", në të cilën krahas lajmeve për aktivitetet dhe ngjarjet janë publikuar edhe foto ilustruese nga ato aktivitete, por edhe vendime a shkresa të SBASHK-ut drejtuar institucioneve, por

edhe shkresa zyrtare të tjerëve drejtuar sindikatës sonë.

Për t'u përmbyllur me sukses ky mision zyra për informim e SBASHK-ut, e ndihmuar nga i tërë stafi në qendër, vazhdon me traditën e botimit të gazetës vjetore me emrin simbolik "Rrugëtimi i SBASHK-ut".

"Rrugëtimi i SBASHK-ut 2019" është munduar të kthej te lexuesi kujtesën për ngjarje të shumta e të rëndësishme, që kanë të bëjnë me angazhimet, arritjet, por edhe sfidat me të cilat u përball SBASHK-u gjatë gjithë vitit 2019.



Besojmë se lexuesit do të ndjehen mirë duke e shfletuar këtë dhuratë dhe ne që punuam në "Rrugëtimi i SBASHK-ut 2019" ju dëshirojmë lexim të këndshëm, suksese të shumta në vitin 2020 duke kërkuar falje që tani, nëse na ka ikur ndonjë gabim i rastit në cilën do faqe të gazetës.

